



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 21 të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, nenit 18 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim, nenit 21, 22, 44 dhe 87 të Ligjit Nr. 05/L-03 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 17, pika “d” të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr. 06/2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrërimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, si dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr.350/02-94300/24 dt.19.07.2024, në emër të aplikuesëve/ pronarëve, Ismajl, Ramadan, Sami, Mehdi dhe Ali Qyqalla nga Prishtina me Investitor “Nic & Albion” sh.p.k me seli në Graçanicë, me nr. unik. Identifikues të biznesit 810024159, (Grupi i I-rë), dhe të pronarëve Shevqet Ismaili, Ilir, Xhemail, Ismail dhe Bujar Sadiku dhe Naim Berisha (qirambajtje 99 vite - “P.SH - KBI-Kosova-Export”), nga Prishtina me Investitor “Onyx Holding” sh.p.k me seli në Prishtina, me nr. unik identifikues të biznesit 812057877, (Grupi i II-të), për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit kryesor, për ndërtimin e kompleksit me ndërtesa shumë banesore & afariste, – “Ndërtesa “1”, “2”, “3”, “4”, “5” dhe “6” (për Grupi I), dhe “Ndërtesa “7”, “8”, “9”, “10” dhe “11” (për Grupi II), në kuadër të Bllokut urban “A-13”, Tërësia urbane “A”, të Planit Rregullues “Prishtina e Re – Zona Qendër” në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë të rregullt administrative, me datë 22.04.2025, merr këtë:

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E KUSHTEVE NDËRTIMORE

I. caktohen kushtet ndërtimore aplikuesëve/pronarëve, Ismajl, Ramadan, Sami, Mehdi dhe Ali Qyqalla nga Prishtina me Investitorë “Nic & Albion” sh.p.k me seli në Graçanicë, me nr. unik. Identifikues të biznesit 810024159, (Grupi i I-rë) dhe të pronarëve Shevqet Ismaili, Ilir, Xhemail Ismail dhe Bujar Sadiku dhe Naim Berisha (qirambajtje 99 vite - “P.SH - KBI-Kosova-Export”), nga Prishtina me Investitorë “Onyx Holding” sh.p.k me seli në Prishtina, me nr. unik. Identifikues të biznesit 812057877, (Grupi i II-të), sipas kërkesës 05 Nr.350/02-94300/24 dt.19.07.2024, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit kryesor, për ndërtimin e kompleksit me ndërtesa shumë banesore & afariste, – “Ndërtesa “1”, me etazhitet: 2B+2S+P+9, “Ndërtesa “2”, me etazhitet: 2B+S+P+9, “Ndërtesa “3”, me etazhitet: 2B+2S+P+9, “Ndërtesa “4”, me etazhitet: 2B+2S+P+9, “Ndërtesa “5”, me etazhitet: 2B+2S+P+8 dhe “Ndërtesa “6”, me etazhitet: 2B+2S+P+8 (për Grupi I), “Ndërtesa “7”, me etazhitet: 3B+S+P+13, “Ndërtesa “8”, me etazhitet: 3B+S+P+13, “Ndërtesa “9”, me etazhitet: 3B+2S+P+13, “Ndërtesa “10”, me etazhitet: 3B+2S+P+13 dhe “Ndërtesa “11”, me etazhitet: 3B+2S+P+13, (për Grupi II), në kuadër të Bllokut urban “A-13”, Tërësia urbane “A” - Ngastra ndërtimore “C & D”, të Planit Rregullues “Prishtina e Re – Zona Qendër” në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelave kadastrale, nr. 1670-1, 3, 4, 5, 6 ZK Prishtinë (për Grupi I) dhe parcelave kadastrale nr. 1657-2, 15, 25, 28, 31, 1669-0 dhe 10377-3 ZK Prishtinë (për Grupi II) si dhe me trajtim përmes këmbimit të pjesës së parcelës kadastrale nr.1647-0 ZK Prishtinë, me pronar/posedues Komuna e Prishtinës, me parcelën kadastrale, të propozuar, nr.68-6 ZK Matiçan, në pronësi private të Sami, Ismajl, Ramadan, Ali dhe Mehdi Qyqalla, nga Prishtina, e përfshirë në hapësirë publike të planifikuar–rrugë të planifikuar, në kuadër të Planit Rregullues “Mati I” në Prishtinë.

II. Lokacioni i kompleksit të parcelave për të cilin caktohen kushtet ndërtimore, përfshihet në kuadër të bllokut urban “A-13” - Ngastra ndërtimore “C” dhe “D”, të tërësisë hapësinore “A13” të Planit Rregullues “Prishtina e Re-Zona Qendër” në Prishtinë, miratuar me Vendimin e Komunës së Prishtinës, 01 nr. 035-186861 dt.02.10.2013, dhe sipas këtij plani kjo zonë është e destinuar me tipologji: Ngastra ndërtimore “C” dhe “D” - “BP” me funksion i përzier – kryesisht banim, afarizëm joshqetësues në përdhësë.

III. Gjendja ekzistuese e lokacionit/parcelave kadastrale, sipas gjendjes kadastrale, faktike dhe dokumenteve të planifikimit hapësinor, është:

- Numri, sipërfaqet, pronarët dhe klasa e kualitetit të parcelave kadastrale, janë:

Grupi i I-rë i interesit:

- nr. 1670-1.....S=2103 m²Ismajl (Xhemajl) Qyqalla....."arë e klasës 5";
- nr. 1670-3.....S=2104 m²Ramadan (Xhemajl) Qyqalla....."arë e klasës 5";
- nr. 1670-4.....S=2104 m²Sami (Xhemajl) Qyqalla....."arë e klasës 5";
- nr. 1670-5.....S=2104 m²Mehdi (Xhemajl) Qyqalla....."arë e klasës 5";
- nr. 1670-6.....S=2104 m²Ali (Xhemajl) Qyqalla....."arë e klasës 5";

Totali : S=10,519 m²

Grupi i II-të i interesit :

- nr. 1657-2S=500 m²Shefqet (Azem) Ismaili "arë e klasës 5";
- nr. 1657-15.....S=500 m²Ilir (Qemajl) Sadiku "arë e klasës 5";
- nr. 1657-25.....S=199 m²Ilir Sadiku & Xhemail Sadiku.....infrastrukturë/"rrugë";
- nr. 1657-28.....S=324 m²Bujar (Xhemajl) Sadiku "arë e klasës 5";
- nr. 1657-31.....S=769 m²Ismail Sadiku..... "arë e klasës 5";
- nr. 1669-0.....S=1215m²Naim Berisha (qirambajtje 99 vite - "P.SH - KBI-Kosova-Export").....kullosë e klasës 3";
- nr. 10377-3.....S=7219m²Naim Berisha (qirambajtje 99 vite - "P.SH - KBI-Kosova-Export"),....."arë e klasës 4" & "kullosë e klasës 3";

Totali: S=10,726 m²

Sipërfaqja e parcelave kadastrale (Grupi I dhe Grupi II): S=21245 m²

- nr. 1647-0.....S=641 m² (nga totali S=6657m²).....Komuna e Prishtinës....."kullosë e klasës 3" (trajtohet përmes këmbimit);

Sipërfaqja e përgjithshme e parcelave kadastrale, për trajtim: S=21245 +641 =21886 m²

Sipërfaqja e parcelës kadastrale, të propozuara për këmbim me pronën komunale:

- nr. 68-6.....S=1150 m²Sami, Ismajl, Ramadan, Mehdi dhe Ali Qyqalla....."Arë e klasës 5";
- E drejta pronësore-juridike e parcelave kadastrale të lartcekura, në bazë të certifikatave të njësive kadastrale, është private, kurse e parcelës nr.1647-0 ZK Prishtinë, është pronësi komunale - Komuna e Prishtinës;
- Bazuar në certifikatën e njësisë kadastrale, parcela kadastrale nr.1669-0 dhe nr.10377-3 ZK Prishtinë, janë të ngarkuara me hipotekë nga "NLB Banka" sh.a;
- Parcelat kadastrale nr. 1647-0, me sipërfaqe të tërësishme prej S=6654m² dhe me pronar/posedues Komuna e Prishtinës, në këtë propozim zgjidhje urbane, planifikohet të trajtohet me sipërfaqen prej S=641 m², e cila sipërfaqe përfshihet brenda vijës rregulluese të bllokut urban "A-13" të Planit Rregullues "Prishtina e Re-Zona Qendër" në Prishtinë, dhe është propozuar që e njëjta të këmbëhet me parcelën kadastrale nr. 68-6 ZK Matigan, me sipërfaqe S=1150 m², në pronësi private, e përfshirë në hapësirë publike të planifikuar-rrugë të planifikuar, në kuadër të Planit Rregullues "Mati I" në Prishtinë;
- Në kuadër të parcelës kadastrale nr. 1647-0, shtrihet një ndërtesë-shtëpi individuale e banimit, me etazhitet P+1, dhe e njëjta duhet të rënohet para pajisjes me leje ndërtimore, ndërsa në parcelat tjera nuk ka ndërtim;
- Terreni ka pjerrtësi nga drejtimi veri-jug, me një disnivel H~.6.50 m'; ndërsa në lindje-perendim H-2.50m';
- Qasja ekzistuese në këto parcela është nga rrugët lokale, ekzistuese dhe të asfaltuara;
- Në hapësirën e përfshirë në diametër prej 50m' ka ndërtesa ekzistuese, si: ndërtesa shtëpi individuale banimore dhe ndërtesa shumë banesore dhe afariste;

IV. Projekti konceptual – "zgjidhja urbane" e kompleksit me ndërtesa shumë banesore dhe afariste, e analizuar, studiuar dhe trajtuar me këto kushte ndërtimore, është konceptuar në tri grupacione/faza të realizimit: "Grupi I" dhe "Grupi II", me trajtim të parcelave kadastrale nr. 1670-1, 3, 4, 5, 6, ZK Prishtinë (për Grupi I) dhe parcelave kadastrale nr. 1657-2, 15, 25, 28, 31, 1669-0 dhe 10377-3 ZK Prishtinë (për Grupi II), si dhe me trajtim përmes këmbimit të pjesës së parcelës kadastrale nr.1647-0 ZK Prishtinë, me parcelën kadastrale, të propozuar, nr.68-6 ZK Matigan, në pronësi private të Sami, Ismajl, Ramadan, Mehdi dhe Ali Qyqalla si dhe "Grupi III", me analizë konceptuale të pjesës së parcelës kadastrale nr. 1638-0 ZK

Prishtinë, me sipërfaqe $S=525.00 \text{ m}^2$ (duke llogaritur edhe 20% të parcelës të përfshirë në zonë me destinim publik-rrugë të planifikuar), si në vijim:

a) “Grupi i I-rë” në kuadër të kompleksit me ndërtesa shumë banesore dhe afariste, me “Ndërtesa 01”, “Ndërtesa 02”, “Ndërtesa 03”, “Ndërtesa 04”, “Ndërtesa 05” dhe “Ndërtesa 06”, do të trajtojë pjesët dhe parcelat kadastrale nr. 1670-1, 3, 4, 5, 6, ZK Prishtinë, me sipërfaqja totale e parcelave kadastrale të trajtuara me këtë grup/fazë është $S=11,160 \text{ m}^2$, nga të cilat $S=11,160 \text{ m}^2$, brenda vijës rregulluese parcelës ndërtimore dhe nuk ka sipërfaqe të trajtuar jashtë vijës rregulluese;

b) “Grupi i II-të” në kuadër të kompleksit me ndërtesa shumë banesore dhe afariste, me “Ndërtesa 07”, “Ndërtesa 08”, “Ndërtesa 09”, “Ndërtesa 10” dhe “Ndërtesa 11”, do të trajtojë pjesët e parcelave kadastrale nr. 1657-2, 15, 25, 28, 31, 1669-0 dhe 10377-3 ZK Prishtinë me sipërfaqja totale e parcelave kadastrale të trajtuara me këtë grup / fazë është $S=10,726 \text{ m}^2$, nga të cilat $S=8,536.00 \text{ m}^2$, brenda vijës rregulluese-parcelës ndërtimore dhe $S=2,190 \text{ m}^2$, jashtë vijës rregullues – parcelës ndërtimore dhe

c) “Grupi i III-të” i realizimit të ndërtesës shumëbanesore dhe afariste - “Ndërtesa 12”, është planifikuar të bëhet në kuadër të parcelës kadastrale nr. 1638-0 ZK Prishtinë, me sipërfaqe $S=525.00 \text{ m}^2$ (duke llogaritur edhe 20% të parcelës të përfshirë në zonë me destinim publik-rrugë të planifikuar);

Pajisja me leje ndërtimore për “Ndërtesa 12”, e planifikuar të ndërtohet, sipas analizës së bërë, në parcelën ndërtimore për “Grupi II-të” do të bëhet me kërkesë të pronarit të parcelës kadastrale nr. 1638-8 ZK Prishtinë, dhe investitorit potencial, duke u bazuar në “zgjidhje urbane” të miratuar me këtë vendim për caktimin e kushteve ndërtimore.

V. Kushtet ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit kryesor, për rregullimin e hapësirës për realizimin/ndërtimin e kompleksit të ndërtesave shumë banesore & afariste - “Ndërtesa “1”, “2”, “3”, “4”, “5” dhe “6” (për Grupi I) “Ndërtesa “7”, “8”, “9”, “10” dhe “11” (për Grupi II) në kuadër të parcelave ndërtimore të bllokut urban “C” dhe “D” të tërsisë urbane “A” të Planit Rregullues “Prishtina e Re-Zona Qendër” në Prishtinë, përcaktohen duke konsultuar dhe analizuar dokumentet e planifikimit hapësinor, rregullativën ligjore në fuqi dhe projekt propozimin/zgjidhjen urbane me projekt ideor, dhe ato do të jenë:

- Organizimi dhe qasja në parcela, pozicionimi, gabariti, etazhiteti i ndërtesave shumë banesore & afariste, raporti me vijën rregulluese dhe ndërtimore, si dhe me distancat nga kufiri i parcelës, rrugët dhe vendparkimet e planifikuara, si dhe kushtet tjera për rregullimin e hapësirës, të jenë në tërësi sipas prezantimit grafik të përshkruar në Planin e lokacionit - “zgjidhja urbane”, bashkëngjitur këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore;
- Parcelat dhe pjesët e parcelave kadastrale me sipërfaqet e trajtuara, në pjesën e bllokut urban “A13”, për realizimin e kompleksit me ndërtesë shumë banesore dhe afariste, që përfshihen në ndërtim/parcelë ndërtimore, konkretisht të trajtuara **brenda vijës rregulluese**, për bllokun urban A13 është:

Grupi i I-rë i interesit:

- nr. 1670-1..... $S=2103 \text{ m}^2$
- nr. 1670-3..... $S=2104 \text{ m}^2$
- nr. 1670-4..... $S=2104 \text{ m}^2$
- nr. 1670-5..... $S=2104 \text{ m}^2$
- nr. 1670-6..... $S=2104 \text{ m}^2$
- nr. 1647-0 $S=641 \text{ m}^2$ (e propozuar për këmbim)

Totali: $S=11,160 \text{ m}^2$

Grupi i II-të i interesit:

- nr. 1657-2 $S=500 \text{ m}^2$
- nr. 1657-15..... $S=500 \text{ m}^2$
- nr. 1657-25..... $S=171 \text{ m}^2$
- nr. 1657-28..... $S=188 \text{ m}^2$
- nr. 1657-31..... $S=634 \text{ m}^2$
- nr. 1669-0 $S=1208 \text{ m}^2$
- nr. 10377-3 $S=5335 \text{ m}^2$

Totali: $S= 8,536.00 \text{ m}^2$

Gjithsejtë sipërfaqja brenda vijës rregulluese për grupin e I dhe grupin e II-rë të interesit është $S=11,160 \text{ m}^2 + S=8,536.00 \text{ m}^2 = 19,696.00 \text{ m}^2$

- Parcelat dhe pjesët e parcelave kadastrale me sipërfaqet e trajtuara, në pjesën e blloku urban "A13", për realizimin e kompleksit me ndërtesë shumë banesore dhe afariste, që përfshihen në ndërtim/parcelë ndërtimore, konkretisht të trajtuara **jashtë vijës rregulluese, janë:**

Grupi i I-rë i interesit:

- Nuk ka sipërfaqe të trajtuar jashtë vijës rregulluese;

Grupi i II-të i interesit:

- nr. 1669-0 S=7 m²
- nr. 1657-25 S=28 m²
- nr. 1657-28 S=136 m²
- nr. 1657-31 S=135 m²
- nr. 10377-3 S=1,884 m²

Totali: S=2,190.00 m²

Sipërfaqja e përgjithshme e parcelave, jashtë vijës rregulluese, e trajtur sipas Vendimit 14-464/01-97987/22 dt. 05.05.2022 për Plotësim-Ndryshim të Vendimit 01 Nr. 400-660 dt.26.05.2008 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës.....S=2,190.00 m²

- Me këto kushte ndërtimore në kuadër të parcelave ndërtimore në kuadër të bllokut "A13" të Planit Rregullues "Prishtina e Re – Zona Qendër", planifikohet të ndërtohet kompleksi me ndërtesa shumë banesore & afariste – "Ndërtesa "1", me etazhitet: 2B+S+P+9, "Ndërtesa "2", me etazhitet: 2B+S+P+9, "Ndërtesa "3", me etazhitet: 2B+S+P+9, "Ndërtesa "4", me etazhitet: 2B+S+P+9, "Ndërtesa "5", me etazhitet: 2B+S+P+8 dhe "Ndërtesa "6", me etazhitet: 2B+S+P+8 (për Grupi I), "Ndërtesa "7", me etazhitet: 3B+S+P+12, "Ndërtesa "8", me etazhitet: 3B+S+P+12, "Ndërtesa "9", me etazhitet: 3B+2S+P+11, "Ndërtesa "10", me etazhitet: 3B+2S+P+11+Ph dhe "Ndërtesa "11", me etazhitet: 3B+2S+P+11, (për Grupi II), me sipërfaqe ndërtimore, shtrirje dhe etazhitet, sipas kalkulimeve dhe projekt propozimit, si në vijim:

Kompleksi i ndërtesave shumë banesore dhe afariste - "Ndërtesa "1", "Ndërtesa "2", "Ndërtesa "3", "Ndërtesa "4", Ndërtesa "5", dhe "Ndërtesa "6" (për Grupi I), "Ndërtesa "7", "Ndërtesa "8", "Ndërtesa "9", "Ndërtesa "10" dhe "Ndërtesa "11" (për Grupi II),

Grupi i I-rë i interesit:

- "Ndërtesa 1", S=8,194.68 m² / 5,552.79 m², mbi tokë + 2,641.89 m², nën tokë/
Etazhitet: 2B+S+P+9
- "Ndërtesa 2", S=7,635.43 m² / 5,461.04 m², mbi tokë + 2,174.39 m², nën tokë/
Etazhitet: 2B+S+P+9
- "Ndërtesa 3" S= 11,379.80 m² / 7,168.22 m², mbi tokë + 4,211.58 m², nën tokë/
Etazhitet: 2B+2S+P+9
- "Ndërtesa 4", S=11,708.98 m² / 7,168.22 m², mbi tokë + 4,540.76 m², nën tokë/
Etazhitet: 2B+2S+P+9
- "Ndërtesa 5", S=8,160.56 m² / 5,320.66 m², mbi tokë + 2,839.90 m², nën tokë/
Etazhitet: 2B+2S+P+8
- "Ndërtesa 6", S=6,507.85 m² / 4,362.85 m², mbi tokë + 2,145.00 m², nën tokë/
Etazhitet: 2B+2S+P+7.

Totali: 53,587.29 m² / 35,033.78 m² mbi tokë + 18,553.51 m² nën tokë.

Grupi i II-rë i interesit:

- "Ndërtesa 7", S=7,697.84 m² / 5,746.95 m², mbi tokë + 1,949.90 m², nën tokë/
Etazhitet: 3B+S+P+13
- "Ndërtesa 8", S=9,284.88 m² / 5,447.29 m², mbi tokë + 3,837.60 m², nën tokë/
Etazhitet: 3B+S+P+13
- "Ndërtesa 9", S=10,176.70 m² / 7,163.35 m², mbi tokë + 3,013.35 m², nën tokë/
Etazhitet: 3B+2S+P+13
- "Ndërtesa 10", S=12,277.07 m² / 8,623.52 m², mbi tokë + 3,653.55 m², nën tokë/

Etazhitet: 3B+2S+P+14

“Ndërtesa 11”, $S=11.918.05 \text{ m}^2 / 8,247.90 \text{ m}^2$, mbi tokë + $3,670.15 \text{ m}^2$, nën tokë/

Etazhitet: 3B+2S+P+13

Totali: $51,353.54 \text{ m}^2 / 35,229.00 \text{ m}^2$ mbi tokë + $16,124.54 \text{ m}^2$ nën tokë.

Totali i për Grupin I dhe Grupin II: $104,940.83 \text{ m}^2 / 70,262.78 \text{ m}^2$ mbi toke, $35,678.05 \text{ m}^2$ nën tokë.

- Koeficienti i shfrytëzimit maksimal të parcelave kadastrale-parcelës ndërtimore (ISHP) – për Ngastra “C” dhe “D”, konkretisht shfrytëzimi i parcelave brenda vijës rregulluese, për vendosjen e ndërtesave në bazën-gabaritin e përdhese ose suteranit, për banim është max. 30%, dhe për afarizëm 40%, dhe kjo sipërfaqe është:

“Grupi I-rë”:

$S=11160 \times 0.3=3,348.00 \text{ m}^2$ / lejuar për banim, sipas planit rregullues /,

$S=11160 \times 0.4=4,464.00 \text{ m}^2$ / lejuar për afarizëm, sipas planit rregullues /,

$S=3,237.06 \text{ m}^2$ / për banim, sipas projekt propozimit /.

$S=3,356.25 \text{ m}^2$ / për afarizëm, sipas projekt propozimit /.

“Grupi II-të”:

$S=8536 \times 0.3=2,560.80 \text{ m}^2$ / lejuar për banim, sipas planit rregullues /,

$S=8536 \times 0.4=3,414.40 \text{ m}^2$ / lejuar për afarizëm, sipas planit rregullues /,

$S=2,226.76 \text{ m}^2$ / për banim, sipas projekt propozimit/.

$S=3,413.76 \text{ m}^2$ /për afarizëm, sipas projekt propozimit/.(baza e Suteran -1)/(baza e perdhesa $3,310.98 \text{ m}^2$).

- Koeficienti i shfrytëzimit maksimal të parcelave kadastrale-parcelës ndërtimore (ISHPN), konkretisht shfrytëzimi i parcelave brenda vijës rregulluese, për vendosjen e ndërtesave në bazën-gabaritin e bodrumit, është max. 60%, bazuar në planin rregullues dhe në paragrafin II, pika 1. të Vendimit 01 Nr. 031-185481 dt. 14.08.2015, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, dhe kjo sipërfaqe është:

“Grupi I-rë”:

$S=11160 \times 0.6=6,696.00 \text{ m}^2$ / lejuar sipas Vendimit të Kryetarit dhe planit rregullues /;

$S=6,295.60 \text{ m}^2$ / sipas projekt propozimit /.

“Grupi II-të”:

$S=8536 \times 0.6=5,121.60 \text{ m}^2$ / lejuar sipas Vendimit të Kryetarit dhe planit rregullues /;

$S=4,753.04 \text{ m}^2$ / sipas projekt propozimit /.

- Koeficienti i shfrytëzimit të parcelës ndërtimore për hapësira gjelbëruese (ISGJ), bazuar në planin rregullues dhe në paragrafin II. pika 2. të Vendimit 01 Nr. 031-185481 dt. 14.08.2015, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, është 0.4 (40%), dhe përjashtimisht kur ndërtohet kulmi me gjelbërim, 0.3 (30 %), me gjelbërim të lartë dhe të ultë, si dhe hapësira të organizuara për sport dhe rekreacion, dhe kjo sipërfaqe është:

“Grupi I-rë”:

$S=11160 \times 0.4=4,464.00 \text{ m}^2$ / lejuar sipas Vendimit të Kryetarit dhe planit rregullues /;

$S=11160 \times 0.3=3,348.00 \text{ m}^2$ / lejuar sipas Vendimit të Kryetarit dhe planit rregullues /;

$S=11160 \times 0.1=1,160.00 \text{ m}^2$ / lejuar sipas Vendimit të Kryetarit dhe planit rregullues /;

$S=3,552.60 + 1,279.40 = 4,832.00 \text{ m}^2$ / sipas projekt propozimit/gjelbërim+kulm i gjelbërt /.

“Grupi II-të”:

$S=8536 \times 0.4=3,414.40 \text{ m}^2$ / lejuar sipas Vendimit të Kryetarit dhe planit rregullues /;

$S=8536 \times 0.3=2,560.80 \text{ m}^2$ / lejuar sipas Vendimit të Kryetarit dhe planit rregullues /;

$S=8536 \times 0.1=853.60 \text{ m}^2$ / lejuar sipas Vendimit të Kryetarit dhe planit rregullues /;

$S=3,773.36 + 122.15 = 3,895.51 \text{ m}^2$ / sipas projekt propozimit/kulm i gjelbërt+gjelbërim /.

- Koeficienti i ndërtimit (ISPN) sipas Planit Rregullues “Prishtina e Re – Zona Qendër” është: për ngastra ndërtimore “C”, 3.3, ndërsa për ngastra ndërtimore “D”, 3.0, dhe trajtimi i sipërfaqeve ndërtimore për etazhet ndërtimore do të bëhet – llogaritet, si në vijim: **100%** për etazhet mbi kuotën ± 0.00 , 50% për etazhet me vëllim mbi **51%** apo së paku njëra ballore mbi nivelin e tokës - **suteran**, dhe **0%** për etazhet e nëntokës – **bodrum**, dhe kjo sipërfaqe është:

“Grupi I-rë”:

$S=5188 \times 3.3 = 17120.40 \text{ m}^2$ / lejuar sipas planit rregullues, për ngastrën ndërtimore “C” /,

$S=5972 \times 3.0 = 17916.00 \text{ m}^2$ / lejuar sipas planit rregullues, për ngastrën ndërtimore “D” /

$S=35,036.40 \text{ m}^2$ / i lejuar sipas planit rregullues;

$S=35,033.78 \text{ m}^2$ / sipas projekt propozimit /

Për Grupi II-të:

$S=8,392 \times 3.3 = 27,693.60 \text{ m}^2$ / lejuar sipas planit rregullues, për ngastrën ndërtimore “C” /,

$S=144 \times 3.0=432.00 \text{ m}^2$ / lejuar sipas planit rregullues, për ngastrën ndërtimore "D"/,

$S=7104 \text{ m}^2$ / kompensimin,

$S=35,229.00 \text{ m}^2$ / sipas projekt propozimit /.

- Me aplikimin e Vendimit 14 Nr.464/01-97987/22 dt. 05.05.2022 për Plotësim-Ndryshim të Vendimit 01 Nr. 400-660 dt.26.05.2008 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, për kompensimin e pronës private, të planifikuar për interes publik, me koeficient të ndërtimit, do të mundësohet që sipërfaqja e parcelës ndërtimore (brenda vijës rregulluese) të shtohet deri në 20 % të sipërfaqes së përgjithshme të parcelës ndërtimore, me sipërfaqe $S=2190 \text{ m}^2$, e përfshirë jashtë vijës rregulluese, kjo sipërfaqe, e përcaktuar në përqindje (%) është: $S=2190/19696 \times 100=11.12 \%$. Sipas kësaj llogarie, pronarët dhe investitori (Grupi II-të – Ngastra ndërtimore "C" dhe "D"), për sipërfaqen e theksuar, do të kompenzohen me koeficientin 3.0 & 3.3 dhe sipas kalkulimit: për Ngastra "C" - $S=1,780 \times 3.3=5,874.00 \text{ m}^2$, dhe për Ngastra ndërtimore "D", dhe $S=410 \times 3.0=1,230.00 \text{ m}^2$, dhe në total, për Grupi II-të, për Ngastra ndërtimore "C" dhe "D", $S=5,874.00 + 1,230.00=7,104.00 \text{ m}^2$.

Për Grupi I-rë dhe Grupi II-të, sipërfaqja e përgjithshme e lejuar për ndërtim, duke përfshirë edhe shpronësimin, është:

$$S=17120.40+17916.00+27693.60+432.00+7104.00=70266.00 \text{ m}^2$$

- Bazuar në nenin III. të Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës dt. 14.08.2016 dhe protokoluar me numrin 01 nr. 031-185481, për shkaqe të kursimit dhe efijencës së energjisë, sipërfaqja që zë shtresa e "termoizolimit", nuk përfshihet në kalkulimin e sipërfaqes së përgjithshme ndërtimore e as në kalkulimin për taksë dhe tarifë për leje ndërtimore;
- Bazuar në kriteret e planit rregullues për bllokun urban "A13", për ngastrën ndërtimore "C" dhe "D", e tërë sipërfaqja ndërtimore është paraparë të jetë për banim dhe afarizëm joshqetësues në përdhese, ndërsa bazuar në pjesën tekstuale të planit rregullues, konkretisht kapitulli 15, paragrafi i parë, lejohet shfrytëzimi i përmbajtjeve me funksion të përzier, banim dhe afarizëm joshqetësues në përdhese.
- Etazhiteti maksimal për bllokun urban A13 të tërësisë hapësinore "C" të Planit Rregullues "Prishtina e Re-Qendër", është V÷XI etazhe mbi tokë, ndërsa për bllokun "D" është IV÷VIII etazhe mbi tokë. Sipas projekt propozimit etazhiteti maksimal për bllokun "C" është 3B+2S+P+12, ndërsa për bllokun "D" është 3B+2S+P+8. Etazhiteti mund të ndryshohet-rritet nëse aplikohet Vendimi 14 nr.464/01-97987/22 dt.05.05.2022 për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit 01nr.400-660 dt.26.05.2008, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, për kompensimin e pronës private të paraparë për interes publik, me koeficient të ndërtimit;
- Bazuar në kriteret e planit rregullues, distanca minimale ballore në mes të ndërtesave të jetë 1.0xH (ku H, është lartësia mbi tokë e ndërtesës), kurse e ndërtesës me kufirin e parcelës fqinje 0.5xH ose min. 7 m, ku distanca prej 7.0 m vlen edhe në rastet kur në atë fasadë nuk ka hapje – ndriçim primar për hapësirat e banimit (dhoma dite, fjetje, pune, tryezari, etj). Distanca në mes të ndërtesave (shumë banesore apo afariste) të fasadat e kombinuara (njëra ndërtesë fasadë ballore, kurse tjetra ndërtesë fasadë anësore) është 0.6xH;
- Kati i fundit i ndërtesave shumëbanesore duhet të tërhiqet brenda vijës ndërtimore për min. 2.5 m;
- Distanca e nëntokës – bodrumit prej kufirit të parcelave fqinje të jetë min 1.50m.
- Ngjitja e nivelit të përdhësës nga niveli i terrenit- trotuarit të ndërtesës, lejohet max.1.20 m, ndërsa për lokale 0.30m.Gjithsesi duhet të sigurohet qasja në objekt për personat me aftësi të kufizuar.
- Qasja në kompleksin me ndërtesa shumë banesore dhe afariste të jetë nga rruga e planifikuar e planit rregullues urban, sipas Planit i situacionit - "zgjidhja urbane";
- Çdo objekt ndërtimor i planifikuar duhet të jetë i vendosur, me fasadën e përparme në vijën ndërtimore, respektivisht përbrenda hapësirës së kufizuar me vijën ndërtimore;
- Për qarkullim më të lehtë të zjarrfikësve duhet të parashihet qasje e brendshme çdo 50 m', përkatësisht në çdo 50 m duhet të ekzistojë pasazh apo rrugë, me gjerësi min. 4.0 m;
- Në kuadër të kompleksit të parashihen edhe vend-parkimet e jashtme, shtigjet, trotualet kënde të lojërave për fëmijë, terrene sportive, mobiluar urban, etj.;
- Për çdo njësi banesore-rezidenciale të planifikohet 1.0 (një) vend-parkim, ndërsa për pjesët afariste të ndërtesës, varësisht prej destinimit, të parashihen 1 VP / 30 m² të sipërfaqes së vlefshme të shitjes;
- Parcelat ndërtimore të ndërtesave shumëbanesore nuk duhet të rrethohen;
- Në kuadër të parcelës të parashihet hapësira për vendosjen e mbeturinave.
- Arkitektura-dukja e jashtme (fasada) e ndërtesave dhe materializimi i tyre, të jetë me materiale bashkëkohore dhe me masa të efijencës së energjisë, dhe ti përshtatet ambientit për rreth;

• Si dhe aplikimi i të gjithave kushteve tjera urbane dhe arkitektonike të përcaktuara në kriteret dhe parametrat urban të Plani Rregullues “Prishtina e Re-Zona Qendër”.

VI. Kompensimi me koeficient ndërtimi i pjesëve të parcelave kadastrale nr. 10377-3, 1669-0, 1657-28, 1657-25 & 1657-31 ZK Prishtinë (Grupi i II-të), me sipërfaqe $S=2,190\text{ m}^2$, e përfshirë në hapësirë publike të planifikuar – rrugë, për realizimin e ndërtimit të kompleksit me ndërtesa shumëbanesore dhe afariste, të realizohet si më poshtë:

Sipas kalkulimeve në paragrafin IV, parcelat ndërtimore të bllokut urban “A13”, ka sipërfaqe $S=19,696.00\text{ m}^2$, andaj bazuar në Vendimin 14 Nr.464/01-97987/22 dt. 05.05.2022 për Plotësim-Ndryshim të Vendimit 01 Nr. 400-660 dt.26.05.2008 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, dhe kompensimi i pronës private të përfshirë në hapësira me interes publik, mund të realizohet me koeficient të ndërtimit për sipërfaqet deri 20%, dhe sipas kësaj, kjo sipërfaqe përcaktuar në përqindje (%) është $S=2190/19696 \times 100=11.12\%$, e cila sipërfaqe mund të kompensohet. Andaj sipas kësaj llogarie, pronarët dhe investitori, për sipërfaqen e theksuar, kompensohen me sipërfaqe ndërtimore, të llogaritur sipas koeficientit – për Ngastra ndërtimore “C”, 3.3 dhe Ngastra ndërtimore “D” 3.0, dhe sipas kalkulimit, kjo sipërfaqe është: $S=1,780.00 \times 3.3=5,874.00\text{ m}^2$ dhe $S=410 \times 3.0=1,230.00\text{ m}^2$, dhe në total: $S=5,874.00 + 1,230.00=7,104.00\text{ m}^2$.

Kjo drejtori jep PËLQIM për kompensimin me koeficient ndërtimi të pjesëve të parcelës kadastrale, bazuar në vendimet e lartcekura. Kjo procedurë e kompensimit me koeficient ndërtimi, do të realizohet bazuar në pëlqimin e konfirmuar në këtë paragraf, e i cili do të shërbejë si bazë për arritjen e marrëveshjes definitive, në mes të bashkëpronarëve të parcelës dhe Komunës së Prishtinës, konkretisht Drejtorisë së Pronës të Komunës së Prishtinës.

Mos zbatimi i kësaj procedure sipas këtij paragrafi, nga bashkëpronarët dhe investitori, për arsye të ndryshme, detyron Drejtorinë e Urbanizmit, të rishikojë sipërfaqet ndërtimore të ndërtesave shumë banesore dhe afariste, të përcaktuara me këtë vendim për caktimin e kushteve ndërtimore.

VII. Këmbimi i pjesës së parcelës kadastrale nr.1647-0 ZK Prishtinë, me pronar / posedues Komuna e Prishtinës, me sipërfaqe prej $S=641\text{ m}^2$, që shtrihet brenda bllokut për ndërtim, është propozuar nga pronari dhe investitori, të realizohet me parcelën kadastrale nr.836-3 ZK Matigan, me pronar Sami Krasniqi nga Prishtina, e cila është e shtrirë në zonë me destinim publik - “Zona e transportit publik me qëllime speciale sheshe urbane, - nuk lejohen makinat e motorizuara”, në kuadër të Planit Rregullues “Mati I” në Prishtinë, duke bazuar në Ligjin Nr. 04/L-144 dt. 22.11.2012, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës dhe vlerësimin e organit kompetent.

Procedura e këmbimit të bëhet para aplikimit për leje ndërtimore për “Ndërtesa 1” dhe “Ndërtesa 2”, në Drejtorinë e Pronës të Komunës së Prishtinës, sipas përshkrimit në paragrafin **VI. Kushti i veçantë**, të këtij vendimi dhe këtyre kushteve ndërtimore, me kërkesë të pronarëve dhe investitorit, bazuar në Ligjin nr. 04/L-144 dt. 22.11.2012, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës dhe vlerësimin e organit kompetent.

Andaj, kjo drejtori jep PËLQIM për këmbimin e parcelave të lartcekura, sipas Situacioni i parcelës ndërtimore me vijën rregulluese dhe ndërtimore dhe manualit të ndarjes, punuar nga gjeodeti i licencuar. Procedura e këmbimit do të realizohet bazuar në pëlqimin e përshkruar në këtë paragraf, e i cili do të shërbejë si bazë për evidentimin në regjistrin kadastral, të këtyre ndryshimeve.

Procedura e këmbimit do të realizohet, bazuar në vlerësimin e organit kompetent për vlerësimin e pronave, dhe do të zhvillohet para aplikimit për leje ndërtimore në Drejtorinë e Pronës të Komunës së Prishtinës, sipas këtyre kushteve ndërtimore, me kërkesë të pronarëve dhe investitorit, duke u bazuar në Situacioni i parcelës ndërtimore me vijën rregulluese dhe ndërtimore nga Plani Rregullues “Prishtina e Re-Zona Qendër” në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01, punuar nga gjeometri i drejtorisë, i cili është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

VIII. Ndarja/parcelimi i parcelave kadastrale nr. 10377-3, 1669-0, 1657-28, 1657-25 & 1657-31 ZK Prishtinë, do të realizohet sipas Situacionit të parcelës ndërtimore me vijën rregulluese dhe ndërtimore, Planit të situacionit-“zgjidhja urbane” dhe manualit të ndarjes, punuar nga gjeodeti i licencuar.

Andaj, kjo drejtori jep PËLQIM për ndarjen e parcelave kadastrale të lartë cekura, sipas Planit të situacionit - “zgjidhja urbane” dhe “Situacioni i parcelave me vijën ndërtimore dhe rregulluese nga plani rregullues në sistemin koordinativ KosovaREF01”, punuar nga kjo drejtori dhe manuali i ndarjes, punuar nga gjeodeti i licencuar. Procedura e ndarjes/parcelimit do të realizohet bazuar në pëlqimin e konfirmuar në këtë paragraf, e i cili do të shërbejë si bazë për evidentimin në regjistrin kadastral, të këtyre ndryshimeve.

Procedura e ndarjes të bëhet para aplikimit për leje ndërtimore, në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, sipas vendimit të kushteve ndërtimore dhe me kërkesë të pronarëve dhe investitorit, duke u bazuar edhe në, Plani i situacionit - “zgjidhja urbane” dhe “Situacioni i parcelave me vijën ndërtimore dhe

rregulluese nga plani rregullues në sistemin koordinativ KosovaREF01”, punuar nga kjo drejtori dhe manualit të ndarjes, punuar nga gjeometri i licencuar, e të cilat janë pjesë përbërëse të këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore.

IX. Bashkimi i parcelave dhe pjesëve të parcelave kadastrale nr. 1670-1, 1670-3, 1670-4, 1670-5, 1670-6 & 1647-0 ZK Prishtinë (për “Grupi I-rë”), do të realizohet sipas vijës rregulluese të bllokut urban, sipas manualit të bashkimit, punuar nga kompania gjeodezike e licencuar “Smart Geometrics” shpk nga Prishtina, me licencë nr.278, dhe parcelave kadastrale nr. 10377-3, 1669-0, 1657-28, 1657-25, 1657-31, 1657-15, 1657-2 ZK Prishtinë (për “Grupi II-të”), do të realizohet sipas vijës rregulluese të bllokut urban, sipas manualit të bashkimit, punuar nga kompania gjeodezike e licencuar “GeoGroup” shpk nga Prishtina, me licencë nr.52.

Kjo Drejtori përmes këtij paragrafi jep PËLQIM për bashkimin e parcelave kadastrale të lartcekura, sipas Manualit të bashkimit punuar nga gjeodeti i licencuar. Procedura e bashkimit do të realizohet bazuar në pëlqimin e konfirmuar në këtë paragraf, i cili do të shërbejë si bazë për evidentimin në regjistrin kadastral, të këtyre ndryshimeve.

Procedura e bashkimit të parcelave kadastrale, sipas përshkrimit në paragrafin e parë, të bëhet para aplikimit për leje ndërtimore për “Ndërtesa “3”, “Ndërtesa “4”, Ndërtesa “5”, dhe “Ndërtesa “6” (për Grupi I), dhe “Ndërtesa “7”, “Ndërtesa “8”, “Ndërtesa “9”, “Ndërtesa “10” dhe “Ndërtesa “11” (për Grupi II), në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, sipas këtyre kushteve ndërtimore dhe me kërkesë të pronarëve dhe investitorit, duke u bazuar edhe në, Planin e situacionit - “zgjidhjen urbane” dhe “Situacioni i parcelave me vijën ndërtimore dhe rregulluese nga plani rregullues në sistemin koordinativ KosovaREF01”, punuar nga kjo drejtori, e i cili është pjesë përbërëse e këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore.

Ndërsa, më pas, pas përfundimit të procedurës së këmbimit, sipas përshkrimit në pikën VIII., të këtij vendimi, duhet të bëhet bashkimi i parcelave ndërtimore për Grupi I dhe Grupi II, për formimin e parcelës ndërtimore për të dy grupacionet.

X. Kushti i veçantë, i caktuar bazuar në nenin 45 të Ligjit Nr. 05/L-03 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ka të bëjë me:

a) lejin e ndërtimit të Ndërtesa “1 dhe 2”, me etazhitet 2B+S+P+9, nga subjekti juridik “Nic Albioni” shpk nga Prishtina, si investitor për “Grupi I”, dhe i njëjti duhet të përmbushet / realizohet pas zhvillimit të procedurave, si në vijim:

- Këmbimi i pjesës së parcelës kadastrale nr.1647-0 ZK Prishtinë, në pronësi komunale, sipas përshkrimit në paragrafin VII./ Këmbimi /, të këtij vendimi;
- Pas përfundimit të procedurës së këmbimit, të bëhet bashkimi i parcelave ndërtimore, të formuara për për Grupi I dhe Grupi II, në një parcelë ndërtimore, të vetme;
- Të bëhet vazhdimi i vlefshmërisë të akteve noteriale “Kontrata për ndërtimin e përbashkët dhe rregullimin e raporteve pronësore”, me LRP nr. 9483/ 2023, Ref.nr.4516/ 2023 dt.27.10.2023 dhe Kontrata për ndërtim dhe investim të përbashkët LRP nr. 9819/2023, Ref.nr.827/2023 dt.11.12.2023;
- Të sigurohet pëlqimi nga pengmarrësi për hipotekën e ngarkuar në parcelata kadastrale nr. 1669-0 dhe 10377-3 ZK Prishtinë;

b) me lejin e ndërtimit të Ndërtesa, me etazhitet 3B+2S+P+7, në hapësirën e rezervuar, sipas pjesës grafike-situacionit të bashkëngjitur me këtë vendim, me sipërfaqe ndërtimore, të llogaritur për pjesën e parcelës kadastrale nr. 1663-8 ZK Prishtinë, me sipërfaqe $S=525m^2$, sipas koeficientit 3.3 (duke përfshirë edhe 20%, të saj, për shpronësim), dhe paraprakisht bashkimin e parcelave ndërtimore, që do të formohen për “Grupi I” dhe “Grupi II”, me pjesën e kësaj parcele kadastrale, e përfshirë brenda vijës rregulluese të bllokut urban “A13”, duke u mbështet në aktin noterial “Deklaratë e njëanshme juridike”, me LRP nr. 3135/ 2025, dt.18.04.2025, dhenë nga subjekti juridik / investitori “Onyx Holding” shpk nga Prishtina;

Mos plotësimi i kushtit të veçantë, sipas përshkrimit në këtë paragraf, për arsye të ndryshme, obligon Drejtorinë e Urbanizmit të rishikojë vendimin për caktimin e kushteve ndërtimore, dhe të veprojë konform rregullativës ligjore në fuqi.

XI. Kyçja në infrastrukturë - për marrjen e pëlqimeve nga KEDS-i dhe KRU “Prishtina” aplikimi do të bëhet nga kjo drejtori. Për aplikim nevojitet prezantimi i dokumentacionit, me përcaktim të vendeve për kyçje në rrjetet përkatëse, i dorëzuar veçantë në CD, me përmbajtje si në vijim:

- Emri (prindi) mbiemri i aplikuesit, numri i identifikimit dhe adresa;
- Informatën mbi lokacionin - adresa e saktë e hapësirës ndërtuese;
- Kopjen e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale;
- Planin e situacionit (dispozita urbanistike pjesë përbërëse e kushteve ndërtimore) dhe pamjen në ortofoto të lokacionit me hapësirën ndërtuese;

• Përshkrimin teknik të objektit (destinimi dhe kapaciteti i nevojshëm për energji elektrike dhe ujësjellës). Kyçja në infrastrukturë për ngrohje qendrore të bëhet në rrjetin ekzistues, pas sigurimit paraprak të kushteve detale dhe pëlqimit për kyçe nga "Termokos" - Ngrohitorja e Qytetit dhe PTK-ja.

XII. Dokumentacioni ndërtimor/projekti kryesor, të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe me kualifikime përkatëse për secilën fazë të projektit, duke u bazuar në kushtet ndërtimore të caktuara në pikën IV., projekt propozimin e prezantuar, "Udhëzimi Administrativ i MMPH-së Nr.06/2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve", "Udhëzimi Administrativ i MMPH-së Nr.08/2017 për normat teknike të planifikimit hapësinorë, "Rregullore MMPH Nr. 03/2016 për normat minimale teknike për ndërtesat e banimit në bashkëpronësi", bazuar në "Udhëzim Administrativ Nr. 33/2007 për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuara", normave teknike për siguri nga zjarri si dhe normave dhe standardeve tjera për projektim të kësaj kategorie të ndërtesave, të dorëzohet në tre (3) kopje të shtypura, dhe një (1) digjitale, dhe të përmbajë:

- Lokacionin e parcelës ndërtimore në kuadër të zonës;
- Situacionin-planin e lokacionit, të gjerë në diametër prej 50 m', me ndërtesa ekzistuese dhe ndërtesat e planifikuara, në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000;
- Situacionin-planin e lokacionit 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë;
- Situacionin-"zgjidhja urbane" në përpjesë 1:200 ose 1:500, me pozicionim të ndërtesave në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese, me kuota relative dhe absolute;
- Incizimin gjeodezik të parcelës ndërtimore me rrethinë, si dhe me pozicionim të ndërtesave të projektuara dhe infrastrukturës rrugore, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01;
- Të gjitha bazat, prerjet dhe dukjet e fasadave, në përpjesë 1:50, për ndërtesat e projektuara, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese dhe etazheve tjera me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Përshkrimin teknik me paramasë dhe parallogari të punëve ndërtimore dhe ndërtimore - zejtare;
- Detajet e nevojshme në përpjesë 1:5, 1:10 apo 1:20 dhe specifikimin e zdrukthëtarisë me përshkrimin e materialit të dyerve dhe dritareve, në përpjesë 1:50;
- Projektin e organizimit të kompleksit, me rrugë, shtigje, mobiliarin urban, etj;
- Projektin e strukturës së ndërtimit - llogarinë statike, me përshkrim teknik, pozicionim dhe detaje të nevojshme;
- Projektin e instalimeve elektro-energjetike, me përcaktimin e vendit për kyçe në rrjetin energjetik të qytetit dhe pozicionimin e trafostacionit;
- Projektin e instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, me përcaktimin e vendit për kyçe në rrjetin e qytetit;
- Projektin e instalimeve të makinerisë, me përcaktimin e vendit për kyçe në rrjetin e qytetit;
- Elaborati i "Organizmi dhe masat e sigurisë në vendndërtim", bazuar në Vendimin 01 nr. 035-174324 dt. 12.07.2016 e Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Elaboratin e fizikës ndërtimore dhe atë të mbrojtjes nga zhurma;
- Elaboratin gjeomekanik në bazë të analizave në terrenit;

XIII. Dokumentacioni ndërtimor - Elaborati për Masat e mbrojtëse nga zjarri, hartuar nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet nga kjo drejtori në kompetencë të Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit të Komunës së Prishtinës, për sigurimin e "Deklaratë" për Masat e mbrojtjes nga zjarri.

Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Planin e mbrojtjes nga zjarri-elaboratin, të hartuar nga kompani apo individ i licencuar;
- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Situacionin-planin e lokacionit, të gjerë në diametër prej 50m', me ndërtesa ekzistuese dhe ndërtesat e planifikuara, në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000;

